

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

---

### Ekstaza / *el-Wexhd*<sup>1</sup> / الوجد

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

وَرَبَطْنَا عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ إِذْ قَامُوا

<sup>1</sup> *Wexhd* është një emër foljor i nxjerrë nga *wexhede* (e gjetur ose e përjetuar). Kjo zakonisht përkthehet si 'ekstazë'. Ekstaza është rezultati i gjetjes (*wexhd*) së shkaqeve të ngazëllimit shpirtëror; një shkundje e energjisë shpirtërore, që rezulton në një ndjenjë të fortë. Ekstaza haset pa u lutur për të ose pa e pritur dhe shkakton ndikime të ndryshme që mund të ngërthejnë kënaqje, frikë, gëzim të madh ose nervozë. Nëse cilësitë e madhështisë së Tij janë më të spikatura (te adhuresi), tek adhuresi do të mbizotërojë frika; nëse cilësitë e hijeshisë së Tij janë më të spikatura, do të mbizotërojë gëzimi. Kjo po ashtu mund të çojë në disa manifestime fizike, siç janë lëvizjet ritmike të trupit ose një qetësi a prehje e plotë. Kjo mund të shkaktojë edhe derdhje të lotëve dhe rrëqethje, për çka Imam Ibn Tejmije tha se mund të vijë nga *dhikri*. Ai shtoi se atyre që nuk ndikohen aspak nga *dhikri* mund t'u forcohen zemrat. Psherëtimat dhe alivanosjet që ndodhnin në mesin e Tabi'inëve nuk është gjendja më e mirë. Qetësia e sahabëve – argumenton Ibn Tejmije – është më superiore dhe një tregues i vendosjes së përkryer në stacionet (shkallët) e tyre shpirtërore. Allahu tha:

“Allahu zbriti fjalën më të mirë, një Libër të rregullt, ku ka përsëritje (të urtësive). Atyre që e kanë frikë Zotin e tyre, u rrëqethen lëkurat prej tij, pastaj lëkurat dhe zemrat e tyre qetësohen me kujtimin e Allahut.” (ez-Zumer, 23)

Të kërkosh këto gjendje shpirtërore duke vallëzuar është një novacion në fe (bidat), që nuk njihet më herët midis paraardhësve të mirë (selefëve). *Tewxhud* (kërkimi i ekstazës) lejohet, nëse kjo nuk bëhet sa për t'u dukur dhe bëhet me anë të mënyrave të përshtatshme të *dhikrit*, me lexim të Kuranit dhe me reflektim. Pejgamberi ﷺ tha:

“Kur të thirret ikameti, mos vraponi për ta zënë namazin, por vazhdoni të qetë dhe me hir. Falni atë që mbërrini (me xhemat) dhe plotësoni atë që ju ikën.” (*Mutefekun alejhi*)

“Dhe Ne i bëmë të qëndrueshme zemrat e tyre, kur ata u ngritën ...”<sup>2</sup> (el-Kehf, 14)

*Wexhd* ose ekstaza është një zjarr që ndizet me përjetimin e një ndeshjeje ngacmuese.<sup>3</sup> Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është një gjetje kalimtare, që alarmon të dëgjuarit, të parët dhe reflektimin e vëmendshëm, pavarësisht se a bën kjo apo nuk bën një ndikim (të përhershëm) në përjetësuesin (e gjetjes kalimtare).<sup>4</sup>

Niveli i dytë është një gjetje që ose zgjon shpirtin nëpërmjet shkëlqimit të dritës së para-përjetësisë<sup>5</sup> a dëgjimit të thirrjes së parë<sup>6</sup>, ose duke përjetuar një tërheqje<sup>7</sup> hyjnore. Kjo lë në përjetuesin e saj një rrobë (të përhershme)<sup>8</sup> ose një dritë udhëzuese.

---

<sup>2</sup> Pjesa tjetër e ajetit: “ ... dhe tha: ‘Zoti ynë është Zoti i qiejve e i tokës. Ne nuk lusim zota të tjerë krahas Tij; (nëse do ta bënim këtë) do të shprehnim një hata të madhe.’”

Shejhu mendonte se ngritja ose qëndrimi i tyre shkaktohej nga përjetimet e tyre shpirtërore.

<sup>3</sup> Ibn el-Kajjim sqaron në *el-Medaarixh* arsyen e këtij përkufizimi. Ai argumenton se për shejhun (el-Harawi) *wexhd* / ekstaza është shkallë më e ulët sesa *wuxhuud* (realizimi). Ajo është një ndeshje që alarmon të dashuruarin dhe ia tregon të dashurin, gjë që trazon atë, derisa të arrijë të ngrihet shpirtërisht në praninë e Tij.

<sup>4</sup> Kjo mund të jetë afatshkurtër. Nëse është e vërtetë dhe vjen nga hyjnorja, do të bëjë ndikim të mirë. Mirëpo, ky ndikim mund të mposhtet nga forca të tjera të moskujdesit.

<sup>5</sup> Tash shpirti është pranues i atyre gjendjeve. Ndryshe nga mjetet e tij – të dëgjuarit, të parët dhe intelektit – shpirti shkon përtej shenjave drejtuese për të njohur Atë për tek i cili orientojnë të gjitha ato shenja.

<sup>6</sup> Kjo mund t’i referohet aktivizimit të besatimit të bërë nga shpirtat tanë para se të zbritnin në materien e trupave tanë. Allahu tha:

“Kujto kur Zoti yt nxori pasardhësit e Ademit prej ijëve të tyre dhe i bëri të dëshmonin për vetët e tyre (duke u thënë): ‘A nuk jam Unë Zoti juaj?’ Ata thanë: ‘Po, dëshmojmë që je.’” (el-A’raf, 172)

<sup>7</sup> Shumë njerëz kanë përjetuar këtë atëherë kur janë tërhequr nga gjynahu në dëgjueshmëri ose nga një shkallë në një tjetër më të lartë.

<sup>8</sup> Duke e vendosur mirë në një prej shkallëve (stacioneve) fisnike.

Niveli i tretë është një gjetje që rrëmben robin nga kapja e dy botëve<sup>9</sup> duke e dëlir nga ndyrësia e interesit vetjak dhe duke e liruar nga robëria e ujit dhe e dheut. Kjo ose do ta bëjë atë të harrojë emrin e vet<sup>10</sup>, ose do ta lërë atë në një pozitë më të ulët<sup>11</sup>.

---

<sup>9</sup> Kësaj bote dhe botës tjetër. Domethënë, personi do të përthithet nga përqendrimi i tyre (botëve) në Zotin.

<sup>10</sup> Kjo është kur vetvetja (*nefs*) shpërbëhet në të dashurin e vet. Nëse bartësi i emrit zhduket, edhe emri zhduket me të.

<sup>11</sup> Kjo është një gjendje më e ulët sesa vetasgjësimi.